**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**BASHKIA FUSHE-ARREZ**

**SEKTORI I CESHTJEVE SOCIALE**

Projekt-Vendim

Nr. 785 Prot                                                                 Fushe-Arrez, me 21/03/2024

**MBI FONDIN E KUSHTEZUAR PER BLLOK NDIHMEN EKONOMIKE DERI NE 6%**

Ne mbeshtetje te ligjit Nr. 57/2019, date 18.07.2019. "Per Asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise" I ndryshuar, Kreu IV, pika 2 te Vendimit Nr.955, date 07.12.2016, te Keshillit te Ministrave "Per percaktimin e kritereve, te procedurave, dokumentacionit dhe mases se perfitimit te ndihmes ekonomike" te ndryshuar, Vendim Nr.5, date 23.02.2018 "Mbi miratimin e kritereve per familjet ne nevoje, me perjashtim te pikes 1,6,7, qe do te trajtohen me ndihmen ekonomike duke perdorur deri ne 6% te fondit te ndihmes ekonomike.

Propozojme :

Te trajtohen me ndihme ekonomike per muajin SHKURT 2024, **35** familje, me fond **143,313** eke nga fondi total i ndihmes ekonomike ne vleren **2.388,552** leke dhe shperndare per perfituesit **6%** ne Shumen **141,227** leke sipas Njesive:

ashkia Qender Fushe-Arrez **17** familje me fond **62,106** leke

jesia Administrative Iballe **6** familje me fond **25,028** leke

jesia Administrative Qafe-Mali **6** familje me fond **29,760** leke

esia Administrative Fierze **2** familje me fond **6,752** leke

esia Administrative Blerim **4** familje me fond **17,581** leke

**Pergjegjese e Ceshtjeve Sociale**

**Fitnete ARIFAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI

Nr. 783 Prot                                        Fushë-Arrëz, më 20.03.2024

**P/VENDIM**

**Nr. 11, datë 20.03 2024**

**"PËR
KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT VULLNETAR
TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ PËR VITIN 2024"**

Në mbështetje të nenit 29/2 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të nenit 9 dhe 10, të Ligjit nr. 45/2016 "Për vullnetarizmin", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 17.7.2019, "Për miratimin e kodit të etikës së vullnetarit", të Urdhrit nr. 299, datë 6.11.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për formën dhe përmbajtjen e librezës së vullnetarizmit", të Urdhrit nr. 300, datë 6.11.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për formën dhe përmbajtjen e regjistrit të kontratave të vullnetarizmit", duke pasur në konsideratë situaten e jashtezakonshme të krijuar nga zjarret në pyje dhe kullota dhe sugjerimi i AMVV / Ministria e Brendshme si rezultat i konkursit të praktikave të mira, Kryetari i Bashkisë i propozon, Këshilli Bashkiak këtë projekt vendim emergjent si më poshtë;

1. Në cilësinë e ofruesit dhe përfituesit të vullnetarizmit, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, të krijohet "Shërbimi Vullnetar i Bashkisë për mbrojtjen nga zjarri në pyje".
2. Shërbimi Vullnetar i Bashkisë për mbrojtjen nga zjarri në pyje organizohet pranë **Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave** dhe ofron vullnetarizëm në fushat si më poshtë:
   a) Mbrojtja nga zjarri në pyje:
      i. Vëzhgimi dhe sinjalizimi i zjarreve në pyje,
      ii. Vëzhgimi i zonave pyjore për rreziqe të mundshme të cilat mund të shkaktojnë zjarr,
      iii. Dhënia e mbështetjes së autoriteteve lokale për shuarjen e zjarreve,

**Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave** përgjigjet për:

a) Regjistrimin e vullnetarëve;
b) Regjistrimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë apo kërkojnë të ofrojnë vullnetarizëm brenda territorit administrativ të bashkisë Fushë-Arrëz;
c) Organizimin e vullnetarëve në "Skuadra vullnetare", me përbërje 10-15 anëtare, sipas fushës së vullnetarizmit që do të ofrohet;
d) Përgatitjen e planit të aktiviteteve të Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Fushë-Arrëz.
e) Bashkërendimin e veprimtarisë me drejtoritë e bashkisë për identifikimin e nevojave për vullnetarizëm dhe kryerjen e aktiviteteve të vullnetarizmit;
f) Bashkërendimin e veprimtarisë me "Skuadrat vullnetare" dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara, për ofrimin e vullnetarizmit;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI

784 prot

Dt. 20.03.20

P/VENDIM

Nr. 12 date 20.03 2024

# "PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA PËR VITIN 2024 NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ"

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore" ; Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni.30, pika.4, shkronja.c ; ligjit nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi" ; VKM-ne nr.134 date 3.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 date 08.06.2016 të këshillit të ministrave "Për trasferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive" të ndryshuar, si dhe referuar Shkreses Nr.767 Prot datë 19.03.2024 "Per miratimin e Planit te Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarrëve në pyje për vitin 2023" nga DAPK, Bashkia Fushe-Arrez drejtuar Keshillit Bashkiak Fushë-Arrëz ndaj:

- I propozojmë Këshillit miratimin e Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarrëve në pyje dhe kullota për vitin 2024.
- Bashkëlidhur këtij janë Plani i Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarrëve në pyje dhe kullota për vitin 2024 dhe Skema e ndërlidhjes.

**DREJTORI I ADMINISTRIMIT PYJOR**

Ardmir **DODA**

JURISTI
Redona **HASANI**

**KRYETARI**

Hil **CURRI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

**KRYETARI I KËSHILLIT**

Nikolin **BARDHOKU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË ARRËZ

Nr. 632/1, prot

Datë 4.3.2024

**RELACION**

**"Mbi miratimin e Tavaneve Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027"**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz**

**Z. Këshilltarë !**

Hartimi i Tavaneve Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, pregatitet në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Shqipëri", Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore ", neni "41, Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për Manaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 25, neni 26, neni 27 dhe neni 28, Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33, neni 34, neni 35, neni 36, neni 37, neni 38 dhe neni 39, Udhëzimit nr. 23, datë 22/11/2016 "Për proçedurat standarte të pregatitjes se Programit Buxhetor Afatmesëm", Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit Vjetor nr. 6, datë 28/02/2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027".

Gjithashtu, Tavanet Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, janë hartuar duke u bazuar në objektivat e zhvillimit të Bashkisë, të cilat lidhen me funksionet respektive të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara në kuadrin ligjor, në nivel programi, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë njësi. Dokumenti i PBA-së, prezanton qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program, duke u fokusuar në programet më prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit.

Ky projekt afatmesëm bazohet në vizionin tonë për Fushë-Arrëzin, i cili para së gjithash duhet të jetë një qytet lehtësisht i jetueshëm, me infrastrukturë moderne, me shërbime efikase dhe cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me një jetë kulturore e sportive të larmishme, me hapësira të gjelbërta të dedikuara për fëmijët dhe të moshuarit. Ne jemi të bindur se pavarësisht problemeve të shumta, qyteti i Fushë Arrëzit, mbart një potencial të konsiderueshëm ekonomik, social e kulturor.

Objektivi themelor i këtij Programi Aftmesëm është përmiresimi në vazhdim i cilësisë së jetesës në Bashkinë e Fushë Arrëzit, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollore, përmirësimit të kushteve në çerdhe, kopështe e shkolla, ofrimit të shërbimeve sociale cilësore, rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale, turizmit, etj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa:Fushë-Arrëz, sheshi kryesor i qytetit, Tel:027123131, mob:0692078875 , email.bashkiafushearrez.gov.al

Nr.632,Prot. Datë 04/03/2024

# P/VENDIM

Nr. 10, datë 06/03/2024

## PËR MIRATIMIN E TAVANEVE TË BUXHETIT AFAT MËSËM 2025-2027

Këshilli i Bashkisë Fushë Arrëz në mbledhjen e tij te datës se mësipërme, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Shqipëri", Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore ", neni "41, Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për Manaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 25, neni 26, neni 27 dhe neni 28, Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33, neni 34, neni 35, neni 36, neni 37, neni 38 dhe neni 39, Udhëzimit nr. 23, datë 22/11/2016 "Për proçedurat standarte të pregatitjes se Programit Buxhetor Afatmesëm", Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit Vjetor nr. 3, datë 28/02/2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", pas diskutimit nga Këshilltarë të pranishëm:

## VENDOSI:

**1.**Të miratojë tavanet pergatitore të buxhetit afat mesëm sipas tabelës së mëposhtme:

000/lekë

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Planifikimi i Shpenzimeve të Programit | | 2025-2027 | | PSHP 1 dhe 2 | |
| PSHP 1 dhe PSHP 2 | Tavanet e PBA për institucionin dhe Tavanet e Programit | | | | |
| Emri i Entit: | Bashkia Fushë Arrëz | | | | |
| Numri i Grupit: | 2155001 | | | | |
| Tavani i Institucionit | | | PBA 2025-2027 | | |
| | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2025 | 2026 | 2027 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHLLI

Nr. 640, prot

Datë 06.03.2024

P/VENDIM

Nr. 9, datë 06/03/2024

**PËR**
**DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 35, DATË 29/12/2023, SHPËRNDARJEN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR TË TRASHËGUAR, TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA DHE TRANSFERTËS SPECIFIKE TË TRASHËGUAR NGA VITI 2023.**

Këshilli i Bashkisë Fushë Arrëz në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të Njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore ", neni "18", neni "34", neni "40", neni "41", neni "54" germa "Dh", neni "55" pika 3, neni "64" germa C, Ligjit 68/2017 datë 27/04/2017. "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni "4", neni "5" germat "a & ç", neni "6" germa "d", neni "7" pika "1", neni "21" pika "3", neni "23", neni "33", neni "39", neni "40", neni "41", Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për Manaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", Ligjit 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Ligjit 10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimit nr. 6, datë 28/02/2023 "Për pregatitjen e programit buxhetore afatmesëm 2024-2026", Udhëzimit nr. 23, datë 30/07/2018 "Për proçedurat standarte të pregatitjes së programit buxhetorë afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit nr. 9, datë 20/03/2018 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, si dhe Akt-rakordimit ndërmjet Bashkisë Fushë Arrëz dhe Degës së Thesarit Pukë për Transfertat dhe të ardhurat e trashëguara nga viti 2023, pas diskutimit nga Këshilltarët

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërndarjen sipas tabelës së mëposhtme:

000/lekë

| *Nr.* | *Përshkrimi* | *Viti 2024* |
|---|---|---|
| 1 | Transferta e pakushtëzuar e trashëguar | 11152 |
| | Transferta specifike e trashëguar | 5673 |
| | ***Shuma 1*** | **17275** |
| 2 | Të ardhura të trashëguara | 11636 |
| | ***Shuma 2*** | **11636** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 639/1, prot. Datë 06/03/2024

# PROJEKT - VENDIM

Nr. 8, datë 04/03/2024

## PËR
## DISA SHTESA DHE NRYSHIME NË VENDIMIN NR. 34, DATË 29.12.2023, PËR "MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË ADMINISTRATËS TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ, NJËSIVE ADMINISTRATIVE, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA PËR VITIN 2024"

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore ", neni "64 germa "J", Ligjit 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Ligjit nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhë përfitimive të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe pagës bazë minimale në shkallë vendi, VKM nr. 328 datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve adminisrtativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", VKM nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetë dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", VKM nr. 241, datë 20.04.2023 "Për disa , ndryshime në VKM nr. 175, datë 8.3.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimore dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në Arsimin parauniversitar, të ndryshuar", VKM nr. 240, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr. 350 datë 19.04.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", të ndryshuar, VKM nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, nivelit të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve të disa institucioneve të adminstratës publike", Këshilli i Bashkisë Fushë Arrëz në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni "55", në mbledhjen e tij të rradhës mori në shqyrtim projket vendimin e mësipërm dhe pas diskutimit nga Këshilltarët:

## VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e pagave të Administratës së Bashkisë Fushë Arrëz, Njësive administrative, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.